

Hapet thirrja për bursa për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës për trajnim në Universitetin e Genovas, Itali, në kuadër të Programit Erasmus +

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Genovas, Itali, për vitin akademik 2021 - 2022.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Trajnim për stafin akademik me kohë të plotë;

Kohëzgjatja e mobilitetit:

- 5 + 2 ditë;

Fushat e trajnimit:

-Shkenca sociale dhe të sjelljes;

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (140 Euro/ditë);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik për trajnim:

- CV + Lista e publikimeve (në gjuhën angleze / italiane);

- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze / italiane);

- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze / italiane në nivelin B2;
- Vetëdeklarim nëse keni kryer më parë mobiltete në kuadër të programit Erasmus +, nëse po ku;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie i firmosur vetëm nga aplikanti;

**Plani i mobilitetit është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen gjatë periudhës së mobilitetit.*

Për të shkarkuar formatin e Planit te Mobilitetit klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing-1-1.docx

Afati për aplikim: 20 Tetor 2021

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!